

Njoftim për aplikim për licencim

Në mbledhjen e tij të datës 23.08.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “TEKSOEN 1” me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim nga data 24.08.2023 deri në datën 02.09.2023, pranë zyrave të ERE-s, në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, 1023, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.